



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.GJA.nr.1/2022-7
Më datë 19.01.2022

KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE DHE DEGËVE TË SAJ NË
DRAGASH DHE SUHAREKË PËR VITIN 2021**

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nënparag.2.4 të Ligjit për Gjykatat, paraqes raportin vjetor për vitin 2021.

Në vitin 2021, të cilin e lam pas në Gjykatën Themelore në Prizren dhe Degët e saja në Suharekë dhe Dragash falë organizimit dhe punës së mirë të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës është bërë punë e mirë dhe kemi aritur që për kundër ngarkesave që kishim me pandemin “covid 19”. Kemi arritur të përfundojmë shumë raste ndërto edhe përmes videokonferencave të përfundojmë raste.

Gjykata Themelore me degët e saj funksionon e ndarë në departamente dhe është vërejtur se ekziston një përkushtim dhe praktikë e mirë në punën që bëhet dhe sipas vlerësimit tonë viti 2021 ka qenë vit i sukseshëm duke krahasuar me vitin 2020.

Në periudhën **01.01.2021 deri më 31.12.2021** në Gjykatën Themelore në Prizren janë trashëguar në fillim 11.478 lëndë, kanë arritur gjatë vitit 12.074 lëndë, gjithësejtë në punë kanë qenë 23.552, prej tyre janë kryer 9.200 lëndë, kanë ngelë të pakryera gjithësejtë 13.929 lëndë.

Në gjykatën Themelore në Prizren - dega në Suharekë në fillim të vitit 2021 kanë ngelur në punë 3.971 lëndë, gjatë vitit kanë ardhur 4.710 lëndë gjithësejtë në punë kanë qenë 8.681 lëndë, gjatë vitit janë kryer 3.269 lëndë, dhe në fund kanë ngelur të pa përfunduara 5.375 lëndë.

Në Gjykatën Themelore në Prizren – dega në Dragash, në fillim të vitit 2021 kanë ngelur në punë 745 lëndë, gjatë vitit kanë ardhur 1.243 lëndë, gjithësejtë në punë kanë qenë 1988 lëndë, ndërsa kanë përfunduar 523 lëndë dhe në fund kanë mbetur të pakryera 1.465 lëndë.

Tani ju paraqesim, rezultatet e punës sipas departamenteve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

- **PROCEDURA PARAPRAKE:** Në fillim të vitit 2021, në Departamentin për Krime të Rënda në procedurën paraprake janë trashëguar nga vitet paraprake gjithsejtë 203 lëndë, ndërsa gjatë vitit janë pranuar 654 lëndë, në punë kanë qenë 857 lëndë prej të cilave janë kryer 522 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 327 lëndë, edhe pse hetimet kryhen nga Prokuroria dhe shumë pak varen prej gjykate.

- **LËMIA PENALE** – Në fillim të vitit 2021, në Departamentin për krime të rënda në lëminë penale janë trashëguar nga vitet paraprake gjithsejtë 175 lëndë, ndërsa janë pranuar 176 lëndë, në punë kanë qenë 351 lëndë prej të cilave janë kryer 193 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 156 lëndë, edhe përkundër pengesave këtu janë përfunduar më shumë lëndë se që kemi pranuar.

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

- **PROCEDURA PARAPRAKE-** Në fillim të vitit 2021, në Departamentin e Përgjithshëm në procedurën paraprake janë trashëguar nga vitet paraprake gjithsejtë 563 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 411 lëndë, në punë kanë qenë 974 lëndë prej të cilave janë kryer 496 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 60 lëndë, por hetimet i kryen Prokuroria Themelore dhe kjo nuk varet shumë nga gjykata.

- **LËMIA PENALE-** Në fillim të vitit 2021, në Departamentin e Përgjithshëm në lëminë penale janë trashëguar nga vitet paraprake gjithsejtë 2.588 lëndë penale, janë pranuar 1.498 lëndë në punë, kanë qenë 4.086 lëndë prej të cilave janë kryer 1.685 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 2.396 lëndë, pra ka zvogëlim të numrit të lëndëve të pakryera edhe përkundër pengesave të shumta ky division ka kryer më shumë lëndë se çka kemi pranuar për këtë vit.

LËMIA CIVILE

- **LËNDË CIVILE** - Në fillim të vitit 2021 në lëminë civile janë trashëguar nga vitet paraprake 3.925 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 3.127 lëndë, në punë kanë qenë 7.052 lëndë, prej të cilave janë kryer 1.421 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 5.631 lëndë, pra kemi rritje të numrit të lëndëve të pa përfunduara, pa dyshim në këtë division ka ndikuar numri i vogël i gjyqtarëve.

- **PËRMBARIMORE CIVILE-** Në lëminë e përmbarimeve civile janë trashëguar nga vitet paraprake gjithsejtë 843 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 2.800 lëndë, në punë kanë qenë 3.643 lëndë, prej të cilave janë kryer 1.344 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 2.299 lëndë.

- **LËMIA JOKONTESTIMORE** – Në fillim të vitit janë bartur 469 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 581 lëndë, në punë kanë qenë 1.050 lëndë, janë kryer 221 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 829 lëndë.

- **EKZEKUTIME PENALE ME BURG** - Në këtë lëmi nga vitet parapake janë trashëguar 69 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 145 lëndë, në punë kanë qenë 214 lëndë, prej të cilave janë kryer 134 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 80.

- **EKZEKUTIME PENALE ME GJOBË** - Në vitin 2021 janë bartur 557 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 560 lëndë, në punë kanë qenë 1117 lëndë, prej tyre janë kryer 881 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 236 lëndë.

DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

- **LËNDËT PENALE PARA KOLEGJIT** – Nga vitet e mëparme janë bartur 268 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 100 lëndë, në punë kanë qenë 368 lëndë, janë kryer 152 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 192 lëndë.

- **PROCEDURA PREGADITORE PËR TË MITUR** – Në fillim të vitit, nga vitet e mëparme janë bartur 54 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 42 lëndë, në punë kanë qenë 97 lëndë, janë kryer 89 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 42 lëndë, por procedura pregaditore kryhet nga Prokuroria Themelore dhe pak varet nga puna e gjykatës.

- **DIVIZIONI I KUNDRAVATJTJES** - Nga vitet parapake janë bartur gjithësejt 1.764 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 1979 lëndë, në punë kanë qenë 3743 lëndë, janë kryer 2062 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 1681 lëndë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- DEGA NË DRAGASH

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

- **PROCEDURA PARAPRAKE**- Në fillim të vitit 2021 janë bartur 3 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 58 lëndë, gjithësejt në punë janë 61 lëndë, të kryera 25 lëndë dhe kanë ngelë të papërfunduar 37, por pasi hetimet i kryen Prokuroria Themelore, kjo nuk mvaret shumë nga gjykata.

- **LËMIA PENALE** – Në fillim të vitit 2021 janë bartur 197 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 143 lëndë, në punë kanë qenë 340 lëndë, janë kryer 126 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 213 lëndë, kemi rritje të numrit të lëndëve të pa përfunduara.

- **LËMIA CIVILE** - Në fillim të vitit në lëmin civile janë trashëguar nga vitet parapake 344 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 465 lëndë, në punë kanë qenë 809 lëndë, janë kryer 123 lëndë, kanë mbetur të pakryera 686 lëndë.

- **PËRMBARIMORE CIVILE** - Në fillim të vitit 2021 janë bartur 25 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 358 lëndë, në punë kanë qenë 383 lëndë, janë kryer 61 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 322 lëndë, kemi rritje të numrit të lëndëve të pa përfunduara.

- **EKZEKUTIME PENALE ME BURG** - Në fillim të vitit janë bartur 2 lëndë, gjatë vitit është pranuar 1 lëndë, në punë kanë qenë 3 lëndë, janë kryer 1 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 2 lëndë.

- **EKZEKUTIME PENALE ME GJOBË**- Në fillim të vitit janë trashëguar nga vitet paraprake 60 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 34 lëndë, në punë kanë qenë 94 lëndë, janë kryer 53 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 41 lëndë.

- **LËMIA JOKONTESTIMORE**- Në fillim të vitit janë bartur 24 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 71 lëndë, në punë kanë qenë 95 lëndë, janë kryer 37 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 58 lëndë.

- **DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES**- Në fillim të vitit janë bartur 90 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 113 lëndë, në punë kanë qenë 203 lëndë, janë kryer 97 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 106 lëndë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

- **PROCEDURA PARAPRAKE** –Në fillim të vitit janë bartur 92 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 153 lëndë, në punë kanë qenë 245 lëndë janë kryer 193 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 38 lëndë, mirëpo hetimet i kryen prokurori dhe nuk mvaret shumë nga gjykata.

- **LËMIA PENALE** - Nga vitet paraprake janë bartur 916 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 595 lëndë, në punë kanë qenë 1511 lëndë, janë kryer 906 lëndë.

- **LËMIA CIVILE** – Në fillim të vitit janë trashëguar nga vitet paraprake 1.440 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 1.419 lëndë, në punë kanë qenë 2.859 lëndë, janë kryer 604 lëndë, kanë mbetur të pakryera 2255 lëndë.

- **PËRMBARIMORE CIVILE** –Në fillim të vitit, janë trashëguar nga vitet paraprake 280 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 1.331 lëndë, në punë kanë qenë 1.611 lëndë, janë kryer 441 lëndë, kanë mbetur të pakryera 1.170 lëndë.

- **EKZEKUTIME PENALE ME BURG** – Në fillim të vitit janë trashëguar nga vitet paraprake 29 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 30 lëndë, në punë kanë qenë 59 lëndë, janë kryer 39 lëndë, kanë mbetur të pakryera 20 lëndë.

- **EKZEKUTIME PENALE ME GJOBË** – Në fillim të vitit janë trashëguar nga vitet paraprake 211 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 197 lëndë, në punë kanë qenë 408 lëndë, janë kryer 220 lëndë, kanë mbetur të pakryera 188 lëndë.

- **LËMIA JOKONTESTIMORE** – Në fillim të vitit janë bartur 84 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 162 lëndë, në punë kanë qenë 246 lëndë, janë kryer 166 lëndë, kanë mbetur të pakryera 80 lëndë.

- DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES – Në fillim janë bartur 919 lëndë, gjatë vitit janë pranuar 823 lëndë, në punë kanë qenë 1.742 lëndë, janë kryer 700 lëndë, kanë mbetur të pakryera 1.042 lëndë.

Nga të dhënat që u cekën më lartë rezulton se Gjykata Themelore në Prizren dhe dëget e saja në Suharekë dhe Dragash kanë qenë më efikase se në vitin paraprak.

Edhe në këtë vitë për të cilin po raportojmë nuk ka munguar bashkëpunimi në mes të institucioneve si : Prokuroria, Policia, Shërbimi Sprovues, Ministria e Drejtësisë, shoqërisë civile, mediave etj.

Me Odën Rajonale të Avokatëve kemi takime të rregullta tremujore, janë eliminuar disa dukuri negative rreth caktimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe tani caktimi bëhet në marrëveshje me Odën në mënyrë që të evitohet favorizimi i disa individëve.

Po ashtu, nuk ka munguar edhe rrezultati në përfundimin e lëndëve të strategjisë ashtu që në të gjitha departamentet në gjykatën themelore të Prizrenit, por edhe të degëve të saj janë përfunduar shumica e numrit të lëndëve të strategjisë me përjashtim të rasteve ku ka pengesa objektive, si mungesa e adresave, moszbatimi i urdhërësive të policisë si dhe lëndët për të cilat kërkohet dërgimi i shkresave përmes kanaleve diplomatike, si dhe në rastet ku ka ndërprerje të procedurës për shkak të vdekjes së palëve dhe është e nevojshme të pritet procedura e trashigimisë. Pra sa i përket lëmisë civile janë caktuar edhe lëndët e vitit 2019 - 2020, ashtu që numri i lëndëve të strategjisë është reduktuar dukshëm.

Në vitin që e lamë pasë përparësi ju është dhënë lëndëve të cilat janë të lidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe autorizimit, ashtu që në vitin 2021 janë trajtuar të gjitha këto lëndë me prioritet, te disa lënda të kësaj natyre nuk kanë mundur të përfundohen për shkak pengesave të ndryshme, por të gjitha këto lëndë janë në punë.

Është me rëndësi të ceket se në lëndët siq janë ato: Krime të Rënda dhe penale, gjykata ka qenë efikase, me përjashtime të vogla.

Po ashtu është rritur niveli i transparencës së gjykatës, janë caktuar dy ditë të hapura për pranimin e palëve, zyrtari për informim për çdo ditë lajmëron gazetarët në adresat e tyre elektronike për procesimin e lëndëve, kemi rritur bashkëpunimin me organizatën joqeveritare "EC" më ndryshe, është publikuar një buletin për gjykatën, janë organizuar shumë vizita të studentëve, nxënësve dhe qytetarëve në gjykatë, si dhe janë mbajtur disa debate me ta, është funksionalizuar Web-faqja e gjykatës dhe tani bëhet publikimi i të gjitha vendimeve të plotfuqishme, po ashtu nuk ka munguar bashkëpunimi edhe me organizatat joqeveritare.

Përveq rezultateve që u cekën më lartë, gjykata është ballafaquar dhe ende ballafaqohet me shumë sfida si:

- Jemi ballafaquar me mungesë të gjyqtarëve, kur dihet se disa gjyqtar janë avancuar dhe disa janë pensionuar duke e lënë këtë gjykatë me mungesë të paktën të 7 gjyqtarëve.

- Jemi ballafaquar edhe me mungesë të gjyqtarëve porot (ngase janë të moshuar dhe disa kanë ndëruar jetë)
- Jemi ballafaquar edhe me mungesë të hapsirave, edhe përkundër faktit që i jam drejuar KGJK-së për funksionalizimin e objektit tjetër të kësaj gjykate (objekti ku vepron divizioni i kundërvajtjes) si zgjidhje deri në ndërtimin e objektit të ri.
- Jemi ballafaquar me mungesë të përkthyesëve për gjuhën turke, edhe pse Rajoni i Prizrenit është specifik për përdorimin e gjuhëve.
- Ekziston një numër të madhë i urdhëresave për sjellje me dhunë, sidomos në lëminë e ekzekutimeve të vendimeve të formës së prerë, mirëpo policia çdo here arsyetohet se nuk kanë kapacitete, për kundër raporteve të mira që kemi me ta.
- Sfidë e radhës është ekzekutimi i vendimeve të Divizionit të Kundërvajtjes dhe do të ishte mire që Ligji për Kundërvajtjet të amendamentohet dhe ngajshëm me nenin 46 të Kodit Penal të Kosovës të parashihet mënyra e ekzekutimit të vendimeve me gjobë, përndryshe vendimet vështirë do të ekzekutohet, poashtu duhet të bisedohet me autoritetet e Bankës Qëndrore që ti mundësohet një zyrtari nga Divizioni i Kundërvajtjes që të ketë qasje në xhirollogarit e debitorëve, përndryshe asnjë vendim i Divizionit të kundërvajtjes nuk do të mund të ekzekutohet dhe në këtë mënyrë shteti humbë shuma të mëdha të parave.
- Sfidë paraqet shkatërrimi i lëndëve sepse arkivat e gjykatës janë të mbushura plot lëndë.
- Sfidë e radhës është mos licencimi i ekspertëve dhe interpretëve nga ana e KGJK-së.

Në Gjykatën Themelore në Prizren – dega në Suharekë - Një numër i lëndëve, e sidomos të strategjisë në procedurën kontestimore ku janë të paditur pjestarët e minoritetit Sërbë nuk mund të kryehen në mungesë të adresave të sakëta.

Në Gjykatën Themelore në Prizren - dega në Dragash, gjendja nuk është aspak e mir, për shkak se në këtë degë është mungesa e adresave të sakta të palëve për shkak të lëvizjes së popullatës e sidomos asaj të përkatësisë etnike Gorane, prej të cilëve një numër i madhë janë të punësuar jashtë Republikës së Kosovës.

Përfundimisht, vlerësojmë se e kemi përmbyllur vitin kalendarik 2021 me rrezultate pozitiv, duke patur parasysh sfidat që u cekën më lartë si dhe duke pasur parasysh gjendjen e krijuar për shkak të pandemisë “Covid-19”.

Tani raportit t’ia bashkangjesim edhe tabelën me të dhëna statistikore për të gjitha lëndët që janë përfunduar, dhe kanë ngelur në punë në gjykatën Themelore në Prizren dhe Degët të saj.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Gjykata Themelore - PRIZREN	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2021	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2021	Gjithsej lëndët në punë gjatë vitit 2021	Lëndët e kryera gjatë vitit 2021	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2021	Përqindja e lëndëve të zgjidhura në fund të vitit 2021
Dep. Për Krime Të Rënda	Penale	175	176	351	193	156	109.66
	Paraprake	203	654	857	522	327	79.82
Dep. I Përgjithshëm	Penale	2588	1498	4086	1685	2396	112.48
	Paraprake	563	411	974	496	60	120.68
	Civile	3925	3127	7052	1421	5631	45.44
	E.Civile	843	2800	3643	1344	2299	48.00
	E.P. Me Burg	69	145	214	134	80	92.41
	E.P. Me Gjobë	557	560	1117	881	236	157.32
	Jashtkontestimore	469	581	1050	221	829	38.04
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit	268	100	368	152	192	152.00
	Pregaditore	54	43	97	89	42	206.98
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1764	1979	3743	2062	1681	104.19
TOTALI		11478	12074	23552	9200	13929	76.20


GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - DEGA NË DRAGASH

Gjykata Themelore - Prizren - Dega - Dragash	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2021	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2021	Gjithsej lëndët në punë gjatë vitit 2021	Lëndët e kryera gjatë vitit 2021	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2021	Përqindja e lëndëve të zgjidhura në fund të vitit 2021
Dep. Për Krime Të Rënda	Penale						
	Paraprake						
Dep. I Përgjithshëm	Penale	197	143	340	126	213	88.11
	Paraprake	3	58	61	25	37	43.10
	Civile	344	465	809	123	686	26.45
	E.Civile	25	358	383	61	322	17.04
	E.P. Me Burg	2	1	3	1	2	100.00
	E.P. Me Gjobë	60	34	94	53	41	155.88
	Jashtkontestimore	24	71	95	37	58	52.11
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit						
	Pregaditore						
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	90	113	203	97	106	85.84
TOTALI		745	1243	1988	523	1465	42.08

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË

Gjykata Themelore - Prizren - Dega - Suharekë	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2021	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2021	Gjithsej lëndët në punë gjatë vitit 2021	Lëndët e kryera gjatë vitit 2021	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2021	Përqindja e lëndëve të zgjidhura në fund të vitit 2021
Dep. Për Krime Të Rënda	Penale						
	Paraprake						
Dep. I Përgjithshëm	Penale	916	595	1511	906	582	152.27
	Paraprake	92	153	245	193	38	126.14
	Civile	1440	1419	2859	604	2255	42.57
	E.Civile	280	1331	1611	441	1170	33.13
	E.P. Me Burg	29	30	59	39	20	130.00
	E.P. Me Gjobë	211	197	408	220	188	111.68
	Jashtkontestimore	84	162	246	166	80	102.47
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit						
	Pregaditore						
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	919	823	1742	700	1042	85.05
TOTALI		3971	4710	8681	3269	5375	69.41

Efikasiteti i Gjykatës Themelore - PRIZREN DHE DEGË VJETOR 2021



	DKR	DP	D.MITUR	CIVILE
■ PRIZREN VJETOR	109.66	112.48	152.00	45.44
■ SUHAREKË VJETOR		152.27		42.57
■ DRAGASH VJETOR		88.11		26.45

Me respekt,

U.D Kryetari i Gjykatës Themelore Prizren,
Artan Sejrani

